

20151524362

## **L I G J** **PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR VEPRIMTARI FILMIKE**

### Neni 1

Në Ligjin për veprimtari filmike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13, 18/14, 44/14 dhe 129/15) në nenin 54 fjalët: "prej 2.000 deri 2.500" zëvendësohen me fjalët "prej 700 deri 1.000"

### Neni 2

Neni 55 ndryshohet si vijon:

(1) Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për kundërvajtje të personit juridik nëse:

Nuk dorëzon deri te Agjencia të dhëna për të hyrat e realizuar nga veprimtaria në pajtim me këtë ligj (neni 13 paragrafi (1)),

Nuk i paguan mjetet nga fitimi i realizuar në llogari të Agjencisë (neni 31),

- pa dedikim ose në kundërshtim me marrëveshjen i shfrytëzon mjetet e mara nga Agjencia (neni 39 paragrafi (1)),

Nuk dorëzon deri te Agjencia raport narrativ dhe financiar në pajtim me këtë ligj (neni 39 paragrafi (1)),

-Pamundëson kontroll të shfrytëzimit të mjeteve në pajtim me këtë ligj (neni 39 paragrafi (6)),

- nuk dorëzon të dhëna deri te Agjencia (neni 40 paragrafi (7)),

Nuk e kategorizon filmin para distribuimit të tij, respektivisht shfaqje kinemaje në Republikën e Maqedonisë ose nuk e publikon kategorizimin në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj ose nuk e njofton Agjencinë për kategorizim e ndarë ose nuk e ndryshon kategorizim me kërkesë të Agjencisë (neni 41 paragrafët (2) dhe (3)) dhe

- distribuon respektivisht shfaq film në kinema në kundërshtim me këtë ligj (neni 42).

"(2)Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni i personit përgjegjës në personin juridik".

(3) Gjobë në shumë prej 150 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) alineja 3 dhe 5 të këtij neni personit fizik."

### Neni 3

Në nenin 56 në paragrafin (1) fjalët "prej 15.000 deri 20.000" zëvendësohen me fjalët "prej 5.000", kurse fjalët "paragrafi (3) dhe (4)" zëvendësohet me fjalët "paragrafë (4) dhe (5)".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2)Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni i personit përgjegjës në personin juridik".

### Neni 4

Pas neni 56 shtohet nen i ri 56-a, si vijon:

#### "Neni 56-a

Matja e shumës së gjobës për personin juridik kryhet në pajtim me ligjin për kundërvajtje."

### Neni 5

Në nenin 57 pas fjalës "mban" shtohen fjalët "shqipton edhe sanksione kundërvajtëse".

Neni 6

Titulli i nenit dhe neni 58 ndryshohen si vijojnë:

"Procedura për lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse

Neni 58

"(1) Për kundërvajtje përcaktuar në nenet 54 ,55 dhe 56 nga ky ligj, inspektori për kulturë është i obliguar kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhër pagesë kundërvajtëse, në pajtim me ligjin për kundërvajtje.

(2) Në kryerësi e pranon urdhër pagesën kundërvajtëse, i njëjti duhet ta nënshkruajë. Pranimi i urdhër pagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohen në procesverbal.

(3) Në procesverbalin nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të largohen pasojat nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e kryer.

(4) Kur kryerësi i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbali dhe urdhër pagesa kundërvajtëse e nënshkruan personi përgjegjës ose peron i autorizuar prej tij.

(5) Inspektori për kulturë është i obliguar të mbajnë evidencë për urdhër pagesa e lëshuara kundërvajtëse dhe për epilogun e procedurave të ngritura.

(6) Në evidencën nga paragrafi (5) të këtij neni mblidhen, përpunohet dhe ruhen të dhënat në vijim: Emri dhe mbiemri, respektivisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, respektivisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhër pagesës kundërvajtëse e cila i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

(7) Të dhënat personale nga paragrafi (6) të këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(8) Ministri i Kulturës e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhër pagesës kundërvajtëse."

Neni 7

Akti nënligjor miratimi i të cilit është përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.